

VENDIM
Nr. 51, datë 17.4.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOXHERI ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KOXHERRAJ”, ME FUQI
TË INSTALUAR 0,62 MW,
ME AFAT 30-VJEÇAR**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.4.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Koxheri Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC “Koxherraaj”, me fuqi të instaluar 0,62 MW, për një afat 30-vjeçar,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Koxheri Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm i përcaktuar në nenin 9, pika 1 (formati i aplikimit); nenin 9, pika 2 (dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor); nenin 9, pika 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës, të përcaktuar në nenin 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC); neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); neni 9, pika 4.1.3 (dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.1.4 (dokumentacioni teknik-ekonomik); neni 9, pika 4.1.5 (leje nga institucione të tjera), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Koxheri Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Koxherraaj” me fuqi të instaluar 0,62 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti